

Mesazhet kryesore për farmacistët në spitale

Detyrat

1. Detyrat tuaja lidhur me përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve përfshijnë [42,56,76,94,95]:
 - a) Pjesëmarrjen në ekipin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve (Kujdestaria e Antibiotikëve), si një anëtar kyç i ekipit;
 - b) Bashkëpunimin me specialistin e sëmundjeve infektive dhe mikrobiologun klinik për të zbatuar programin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve;
 - c) Përmirësimin e cilësisë së përshkrimit të antibiotikëve (p.sh. kontrollin për ndërveprimet e ilaçeve, optimizimin e dozës dhe mënyrën e administrimit, parandalimin e efekteve të padëshirueshme);
 - d) Konsultimin me mjekët në spital dhe ofrimin e sugjerimeve për të siguruar cilësinë e përshkrimit të antibiotikëve;
 - e) Zbatimin e ndërhyrjeve të kufizimit të formularit, siç janë kërkesat për përshkrimin e antibiotikëve para miratimit dhe pas autorizimit dhe vlerësimin e respektimit të këtyre kufizimeve;
 - f) Analizimin e të dhënave për përdorimin e antibiotikëve dhe kostot e tyre me qëllim të mbikëqyrjes dhe krahasimit;
 - g) Mbështetjen e udhëzuesve për përdorimin e antibiotikëve në spital, të bazuar në prova, për infeksionet e zakonshme dhe për profilaksinë kirurgjikale;
 - h) Menaxhimin e formularit antimikrobik në spitalin tuaj (d.m.th., lista e ilaçeve të disponueshme për përshkruesit).

Çka duhet të dini?

2. Respektimi i kufizimeve të formularit, si dhe kërkesave të para-miratimit dhe pas-autorizimit për antibiotikë specifike e zvogëlon përdorimin e këtyre antibiotikëve në njësitë e kujdesit intensiv [43].
3. Kalimi nga administrimi parenteral në atë oral nën drejtimin e një farmacisti përmirëson rezultatet klinike për pacientin (p.sh. shkurtimi i kohëzgjatjes së terapisë parenterale pa ndikuar negativisht në rezultatet klinike) [56].

4. Formularët e porosive të veçanta kufizojnë kohëzgjatjen e profilaksisë perioperative me antibiotikë dhe zvogëlojnë incidencën e infeksioneve në vendin e operacionit, përdorimin e antibiotikëve dhe kostot e tyre [56].

5. Farmacistët mund të kenë role të shumta në repartin e urgjencës, duke përfshirë ofrimin e sugjerimeve dhe konsultimeve në kohë reale lidhur me praktikën e përshkrimit dhe identifikimit të ndërveprimeve të ilaçeve. Në këtë mënyrë zvogëlohet kohëzgjatja e trajtimit dhe ulen kostot e përgjithshme të kujdesit shëndetësor [77].

Çka mund të bëni dhe si mund të bashkëpunoni?

6. Mbështetni zhvillimin dhe zbatimin e një programi të administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve brenda organizatës suaj [69,94].

7. Jepni sugjerime dhe këshilla mjekëve në spital lidhur me përzgjedhjen e antibiotikëve, dozën, optimizimin e kohëzgjatjes dhe mënyrën e administrimit [31,94].

8. Inkurajoni klinikistët që të kalojnë nga administrimi parenteral në atë oral në kohën e duhur [56].

9. Kontrolloni recetat e antibiotikëve për të konstatuar sa i respektojnë protokollet e trajtimit me antibiotikë sipas udhëzuesve të bazuar në prova. Nëse shihni anëtarë të stafit në spital ose në mjediset e kujdesit shëndetësor që shkelin udhëzimet ose protokollet, pyetini pse po e bëjnë këtë dhe sigurojuni mjete për të kuptuar se çfarë po bëjnë gabim [69] [konsensusi i ekspertëve].

10. Mblidhni dhe shkëmbeni të dhënat për përdorimin e antibiotikëve dhe kostot e tyre në nivel reparti dhe spitali [56,76].

11. Së bashku me mjekët, ofroni informacione pacientëve që duhet të vazhdojnë terapinë me antibiotikë në shtëpi, pas lirimit nga spitali [31].

12. Trajtoni rregullisht mjekët në spital për përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve dhe merrni pjesë në takime për zbatimin e udhëzuesve për përdorimin e antibiotikëve në spital, të cilët bazohen në dëshmi [31,53,94,95].